



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LUELA V. GERMENJI
ADRESA NR.7, MUHAMED
GJOLLESHA, NR.73/1
TEL: 689075742

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE (AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. reportori: 757

Nr. koleksioni: 439

Tirane më 25/05/2021

/2

Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar
- 3.Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050700043846276

*Akti notarial përbëhet nga 21 fletë



AKTI I THEMELIMIT

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AUTOHAUS CANI SH.P.K”

Sot, më datë 25 /05/2021, para meje **Notere LUELA V. GËRMENJI**, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANË, NR.7, Rr. "MUHAMET GJOLLESHA", NR.73/1, u paraqitën përsoshtisht:

THEMELUES/IT: **Znj. Elona Haka**, atësia Kadri, amësia Habibe, shtetase Shqiptare, lindur në Karbunarë, Lushnjë dhe banuese në Lushnje, me adresë Haka 01830019; Nd. 15; H. 1; Karbunarë; Mollas; 9002; Lushnje, lindur më 21/08/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035967800 dhe Nr. përsoshtisht I95821025D.

THEMELUES/IT: **Z. Altin Cani**, atësia Hasan, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në ZallBastar, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë "Bastar i Mesem" 03990002; Nd. 95; H. 1; Zallbastar; Bastar I Mesëm; 1042; Tiranë, lindur më 13/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035893447 dhe Nr. përsoshtisht J10813062T.

Të cilët, bazuar në **Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Ndryshuar"** dhe nenet përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi, të cilët ntpërmjet këtij **Akti Themelimi, themeluan Shoqërinë "AUTOHAUS CANI" SH.P.K**, e cila përbëhet nga nenet e mëposhtme:

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**AUTOHAUS CANI" SH.P.K.**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**AUTOHAUS CANI" SH.P.K.**, është përsoshtisht juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria "**AUTOHAUS CANI" SH.P.K.**, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe ortakët përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



A2021050700043846276

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: **në Tiranë, Rr. "Demir Lici", zona kadastrale Nr. 1436, Nr. Pasurie 496/122.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Objekti

- ❖ Aktiviteti kryesorë i shoqërisë është: Shitblerje e pasurive te patundshme. Dhenien e ndihmes dhe konsulences per njohjen dhe shfrytezimin e ofertave te tregjeve nderkombetare ne funksion te tregut te brendshem. Dhenie me qira te automjeteve te tonazheve te ndryshme. Shitblerje e automjeteve te tonazheve te ndryshme. Kryerjen e te gjithe operacioneve industriale, tregtare, mobiliare dhe imobiliare, brenda limiteve te kushteve qe mund te jene te nevojshme per permbushjen e qellimit per te cilin eshte krijuar shoqeria. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet imobiliare, mobiliare, tregtare, industriale, financiare apo administrative. Te gjitha aktivitetet e lart permendura mund te zhvillohen si ne tregun tregtar kombetar edhe ne ate nderkombetar. Per realizimin e objektit dhe qellimeve te saj shoqeria mund te ndermarre cdo lloj operacioni financiar te konsideruar si te pershatshem prej saj ne funksion te arritjes dhe zhvillimit te aktivitetit. Shoqeria mund te vendose garanci, hipotekoje ne favor te ndonje banke apo institucion i kreditues. Shoqeria mund te zhvilloje keto sherbime si direkt ashtu edhe nepermjet konsulenteve apo te treteve.
- ❖ Sherbim taksi, program te vecante Business Class me automjete te dizenuara,furgon sherbimi dhe turizmi, sherbim taksi te nje nivel bashkekohor me nje nivel te larte sherbimi dhe trajnimi te vazhdueshem te personelit te sherbimit (shofer),operator te vazhdueshem taksi me nje pakete te pershatshme me mbi 30 automjete me km 0 ne ndihme te mbrojtjes se ambientit,monitorim dhe sherbim me kartat e studenteve, te konsumatoreve te ndryshem,studime dhe menaxhim te vazhdueshem te tregut, pajisjen e automjeteve me GPS pajisjeve dhe sistemetone hitech, dergimit te mjetit duke minimizuar kohen e pritis.
- ❖ Import export me shumice dhe pakice të artikujve të ndryshëm industrial, etj. Import export makinerisht që lidhen me fushen e shërbimeve të konfeksionimeve dhe lavanderive industriale. Çdo lloj sherbimi tjeter qe ka lidhje me fushen e konfeksioneve dhe lavanderive, etj. Shoqëria mund të kryej edhe çdo lloj aktiviteti tjeter ndihmës dhe të nevojshëm dhe që nuk bie ndesh me ligjet në fuqi.
- ❖ Servis automjetesh, punime mekanike, lyerje, xhenerike, pjese kembimi; Import-eksport mallrash industriale, pjese kembimi automjetesh. Kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes dhe te riparimit (servisit) per te gjitha llojet e mjeteve motorike, duke perfshire kryerjen e ketij sherbimi per autoveturat, mjetet e transportit te pasagjereve, kamioneve dhe transportiereve te cdo lloji.
- ❖ Importimin dhe perdonimin nga shoqeria dhe per tregtimin ne tregun e brendshem te vajrave, lubrifikanteve dhe te nenprodukteve te tyre.
- ❖ Sherbime Pastrimi Automjeti, Lavazh dhe sherbim parkimi me ruajtje. Bar- Kafe.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e sajë për një përiudhë kohore të pakufizuar.

KREU II
KAPITALI



A2021050700043846276

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **30.000 Euro** (tridhjetë mijë Euro), i përbërë nga **2 kuota**, me vlerë nominale **15.000 Euro** secila.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë, ortaku **Z. Altin Cani** i cili zoteron **50 %** të kapitalit dhe ortaku **Znj. Elona Haka** i cili zoteron **50 %** të kapitalit.

Investimi në vlerën 30.000 Euro (tridhjetë mijë Euro) është kryer nga ortaku Znj. Elona Haka.
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtëshme/të paluajtëshme apo të drejta.)

Ortakët, që pengohen të ushtrojnë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tijë në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) me akt notarial të shkruar
- e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Përsuni që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit




A2021050700043846276

të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e



A2021050700043846276

mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 11
Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm përsosht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12
Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vodos me tre të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 13
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jenë:



A2021050700043846276

1. Znj. Elona Haka, atësia Kadri, amësia Habibe, shtetase Shqiptare, lindur në Karbunarë, Lushnje dhe banuese në Lushnje, me adresë Haka 01830019; Nd. 15; H. 1; Karbunarë; Mollas; 9002; Lushnje, lindur më 21/08/1989, gjendja civile "beqare", madhere, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035967800 dhe Nr. përsoneal I95821025D.

2. Z. Altin Cani, atësia Hasan, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në ZallBastar, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë "Bastar i Mesem" 03990002; Nd. 95; H. 1; Zallbastar; Bastar I Mesëm; 1042; Tiranë, lindur më 13/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035893447 dhe Nr. përsoneal J10813062T.

Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë **5 vjeçare** me të drejtë ripërtëritje.

Administratorët do të janë me të drejta të plota e të barabarta, por në përfaqësimin e shoqërisë do të janë të pavarrur nga njëri – tjetri duke bërë përfaqësimin e saj.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i Administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një përsone jashtë ortakërisë.

Neni 14
Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme edhe në rastet kur :
 - Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetorë apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe



A2021050700043846276

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët përfaqësojnë Shoqérinë përpara të gjitha pësonave fizike e juridike, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqérinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit/eve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 15 Përgjegjësité

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.



A2021050700043846276

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) ti kthejë ortakëve kontributet;
- b) ti paguajë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) te shpérndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) te lejojë që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet përsonalisht Administratorit, ortakët individualisht ose sëbashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetorë.

Neni 17
Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brënda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, Miraton Bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpérndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18
Eksperët



A2021050700043846276

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakëve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo përsone i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve nga data e emërimit të tijë.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit



A2021050700043846276

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributave të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Neni 23 Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 24 Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

3. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25 Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 26 Baza Ligjore



A2021050700043846276

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në perputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



Neni 27
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 28
Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelim u redaktua në 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe, miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët e Shoqërisë tregtare "**AUTOHAUS CANI**" SH.P.K, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKË DHE THEMELUESIT E SHOQËRISË

"AUTOHAUS CANI" SH.P.K

Z. Altin CANI


Altin Cani

Znj. Elona HAKA

Elona Haka

NOTE RE

LUELA V. GËRMENJI



**TAKSA E PULLËS
ULIKUJDUA**

S T A T U T I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AUTOHAUS CANI SH.P.K”

Sot, më datë 25/05/2021, para meje Notere **LUELA V. GËRMENJI**, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANË, NR.7, Rr. "MUHAMET GJOLLESHA", NR.73/1, u paraqitën përsosalisht:

THEMELUES/IT: **Znj. Elona Haka**, atësia Kadri, amësia Habibe, shtetase Shqiptare, lindur në Karbunarë, Lushnjë dhe banuesë në Lushnje, me adresë Haka 01830019; Nd. 15; H. 1; Karbunarë; Mollas; 9002; Lushnje, lindur më 21/08/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035967800 dhe Nr. përsosali I95821025D.

THEMELUES/IT: **Z. Altin Cani**, atësia Hasan, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në ZallBastar, Tiranë dhe banuesë në Tiranë, me adresë "Bastar i Mesem" 03990002; Nd. 95; H. 1; Zallbastar; Bastar I Mesëm; 1042; Tiranë, lindur më 13/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035893447 dhe Nr. përsosali J10813062T.

Të cilët, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Ndryshuar" dhe nenet përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi, kanë vendusor të redaktojnë Statutin e Shoqërisë "AUTOHAUS CANI" SH.P.K, e cila përbëhet nga nenet e mëposhtme:

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "AUTOHAUS CANI" SH.P.K.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "AUTOHAUS CANI" SH.P.K, është përsosjur juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria "AUTOHAUS CANI" SH.P.K, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe ortakët përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: **në Tiranë, Rr. "Demir Lici"**, zona kadastrale Nr. 1436, Nr. Pasurie **496/122**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asambleës së Ortakëve.

Neni 4
Objekti

- ❖ Aktiviteti kryesorë i shoqërisë është: Shitblerje e pasurive te patundshme. Dhenien e ndihmes dhe konsulences per njohjen dhe shfrytezimin e ofertave te tregjeve nderkombetare ne funksion te tregut te brendshem. Dhenie me qira te automjeteve te tonazheve te ndryshme. Shitblerje e automjeteve te tonazheve te ndryshme. Kryerjen e te gjithe operacioneve industriale, tregtare, mobiliare dhe imobiliare, brenda limiteve te kushteve qe mund te jene te nevojshme per permbushjen e qellimit per te cilin eshte krijuar shoqeria. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet imobiliare, mobiliare, tregtare, industriale, financiare apo administrative. Te gjitha aktivitetet e lart permendura mund te zhvillohen si ne tregun tregtar kombetar edhe ne ate nderkombetar. Per realizimin e objektit dhe qellimeve te saj shoqeria mund te ndermarre cdo lloj operacioni financiar te konsideruar si te pershatshem prej saj ne funksion te arritjes dhe zhvillimit te aktivitetit. Shoqeria mund te vendose garanci, hipotekoje ne favor te ndonje banke apo institucioni kreditues. Shoqeria mund te zhvilloje keto sherbime si direkt ashtu edhe nepermjet konsulenteve apo te treteve.
- ❖ Sherbim taksi, program te vecante Business Class me automjete te dizenuara,furgon sherbimi dhe turizmi, sherbim taksi te nje niveli bashkekohor me nje nivel te larte sherbimi dhe trajnimi te vazhdueshem te personelit te sherbimit (shofer),operator te vazhdueshem taksi me nje pakete te pershatshme me mbi 30 automjete me km 0 ne ndihme te mbrojtjes se ambientit,monitorim dhe sherbim me kartat e studenteve, te konsumatoreve te ndryshem,studime dhe menaxhim te vazhdueshem te tregut, pajisjen e automjeteve me GPS pajisjeve dhe sistemitone hitech, dergimit te mjetit duke minimizuar kohen e pritjes.
- ❖ Import export me shumice dhe pakice të artikujve të ndryshëm industrial, etj. Import export makinerisht që lidhen me fushen e shërbimeve të konfeksionimeve dhe lavanderive industriale. Çdo lloj sherbimi tjeter qe ka lidhje me fushen e konfeksioneve dhe lavanderive, etj. Shoqëria mund të kryej edhe çdo lloj aktiviteti tjeter ndihmës dhe të nevojshëm dhe që nuk bie ndesh me ligjet në fuqi.
- ❖ Servis automjetesh, punime mekanike, lyerje, xhenerike, pjese kembimi; Import-eksport mallrash industriale, pjese kembimi automjetesh. Kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes dhe te riparimit (servisit) per te gjitha llojet e mjeteve motorike, duke perfshire kryerjen e ketij sherbimi per autoveturat, mjetet e transportit te pasajereve, kamioneve dhe transportiereve te cdo lloji.
- ❖ Importimin dhe perdonimin nga shoqeria dhe per tregtimin ne tregun e brendshem te vajrave, lubrifikanteve dhe te nenprodukteve te tyre.
- ❖ Sherbime Pastrimi Automjeti, Lavazh dhe sherbim parkimi me ruajtje. Bar- Kafe.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e sajë për një përiudhë kohore të pakufizuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar



Kapitali themeltar i shoqërisë është **30.000 Euro (tridhjetë mijë Euro)**, i përbërë nga 2 kuota, me vlerë nominale **15.000 Euro** secila.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë, ortaku **Z. Altin Cani** i cili zotëron 50 % të kapitalit dhe ortaku **Znj. Elona Haka** i cili zotëron 50 % të kapitalit.

Investimi në vlerën 30.000 Euro (tridhjetë mijë Euro) është kryer nga ortaku Znj. Elona Haka.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtëshme/të paluajtëshme apo të drejta.)

Ortakët, që pengohen të ushtrojnë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributiveve në natyrë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tijë në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) me akt notarial të shkruar
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kérkon ndryshimi i statutit.

Përsori që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10
Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 11
Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm përsosur, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 12
Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 13
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jenë:

1. Znj. Elona Haka, atësia Kadri, amësia Habibe, shtetase Shqiptare, lindur në Karbunarë, Lushnje dhe banuese në Lushnje, me adresë Haka 01830019; Nd. 15; H. 1; Karbunarë; Mollas; 9002; Lushnje, lindur më 21/08/1989, gjendja civile "beqare", madhere, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternoftim ID Nr. 035967800 dhe Nr. përsos I95821025D.

2. Z. Altin Cani, atësia Hasan, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në ZallBastar, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë "Bastar i Mesem" 03990002; Nd. 95; H. 1; Zallbastar; Bastar I Mesem; 1042;



Tiranë, lindur më 13/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035893447 dhe Nr. personal J10813062T.

Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë **5 vjeçare** me të drejtë ripërtëritje.

Administratorët do të jenë me të drejta të plota e të barabarta, por në përfaqësimin e shoqërisë do të jenë të pavarur nga njëri – tjetri duke bërë përfaqësimin e saj.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, **Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.**

Tagrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i Administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një përsone jashtë ortakërisë.

Neni 14
Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpresa asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpresa asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetorë apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët përfaqësojnë Shoqerinë përpresa të gjitha pësonave fizike e juridike, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.



Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit/eve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 15
Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mës;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) ti kthejë ortakëve kontributet;

b) ti paguajë ortakëve interesa apo dividendë;

c) te shpérndajnë aktivet shoqërisë;

ç) te lejojë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet përsonalisht Administratorit, ortakët individualisht ose sëbashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit përgabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetorë.

Neni 17 Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brënda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finansiar, Mbledhja e Ortakëve, Miraton Bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpérndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finansiar, siç edhe parashikohet nga ligji.


Neni 18 Ekspertët

Eksperti ka përdetyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij përgastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojnë në



pronësi të ortakëve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo përsone i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve nga data e emërimit të tijë.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kérkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Neni 23

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përfundimin e likuidimit dhe kérkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 24
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
3. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe përmalët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 26
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në perputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 27
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe përmes çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 28
Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe, miratohet në parim dhe nen përmes nga Ortakët e Shoqërisë tregtare "AUTOHAUS CANI" SH.P.K, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemlare me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe, miratohet në parim dhe nen përmes nga Ortakët e Shoqërisë Tregtare "AUTOHAUS CANI" SH.P.K dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet, përmes depozituar në Q.K.R. e përmes tu



shpërndarë në organet kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKË DHE THEMELUESIT E SHOQËRISË


"AUTOHAUS CANI" SH.P.K

Z. Altin CANI

Znj. Elona HAKA

Altin cani *Elona Haka*
AH *EH*

**NOTE
LUELA V. GËRMENJI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LUELA V. GERMENJI**

Nr. Rep. 758



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25/05/2021, para meje Notere **LUELA V. GËRMENJI**, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANË, NR.7, RR. "MUHAMET GJOLLESHA", NR.73/1, u paraqit përsosalisht:

DEKLARUES/IT: **Znj. Elona Haka**, atësia Kadri, amësia Habibe, shtetase Shqiptare, lindur në Karbunarë, Lushnjë dhe banuese në Lushnjë, me adresë Haka 01830019; Nd. 15; H. 1; Karbunarë; Mollas; 9002; Lushnjë, lindur më 21/08/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035967800 dhe Nr. përsosal I95821025D.

DEKLARUES/IT: **Z. Altin Cani**, atësia Hasan, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në ZallBastar, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë "Bastar i Mesem" 03990002; Nd. 95; H. 1; Zallbastar; Bastar I Mesëm; 1042; Tiranë, lindur më 13/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 035893447 dhe Nr. përsosal J10813062T.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përparrë meje Noteres, Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqërisë "**AUTOHAUS CANI**" SH.P.K lëshuar më datë 25/05/2021, në Shqipëri nga **Ortakët e Shoqërisë "AUTOHAUS CANI"** SH.P.K, bashkëlidhur këtij vërtetimi.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTE RE
LUELA V. GËRMENJI

*Notere
Luela V. Gërmenji*